LIGJ
Nr. 51/2018

PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES FINANCIARE NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, TË PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË, DHE *CASSA DEPOSITI E PRESTITI S.P.A.* PËR PROGRAMIN E ARSIMIT DHE FORMIMIT PROFESIONAL NËPËRMJET INOVACIONIT

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja financiare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe *Cassa Depositi e Prestiti S.p.A.* për programin e arsimit dhe formimit profesional nëpërmjet inovacionit, me një hua të butë, në shumën 5 000 000 (pesë milionë) euro, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 23.7.2018

Shpallur me dekretin nr.10854, datë 31.7.2018 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta

F.ROT./AID 16/005/00

MARRËVESHJE FINANCIARE

NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, TË PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË DHE *CASSA DEPOSITI E PRESTITI S.P.A.* 5,000,000.00 EURO,

"PROGRAMI I ARSIMIT DHE I FORMIMIT PROFESIONAL NËPËRMJET INOVACIONIT"

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, i përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (në vijim i referuar si "Huamarrësi"), nga njëra anë dhe

Cassa Depositi e Prestiti S.p.A., kapitali aksionar 4,051,143.264.00 euro, me seli në adresën: Rome, Via Goito 4, e regjistruar në Regjistrin e Shoqërive me kod fiskal nr. 80199230584, TVSH nr. 07756511007 (në vijim i referuar si "CDP"), si administratori i Fondit Qarkullues të Bashkëpunimit për Zhvillim, i krijuar nga qeveria e Italisë, sipas nenit 26, të ligjit italian nr. 227, të datës 24 maj 1977, në emër të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave të Republikës së Italisë dhe, në vijim të referuara në nenin 8, të ligjit italian 125/2014, me ndryshimet e herëpashershme, i përfaqësuar nga z. Stefano Gatti, Departamenti i Bashkëpunimit për Zhvillim Ndërkombëtar, përgjegjës i Njësisë së Menaxhimit të Fondit Qarkullues, nga ana tjetër.

(CDP dhe Huamarrësi, së bashku, të referuar në vijim si "Palët".)

Duke pasur parasysh:

A. Në vijim të "Marrëveshjes" (në vijim e referuar si "Marrëveshja") të nënshkruar më 24 shkurt 2017, në Lushnjë, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë dhe qeveria e Republikës së Italisë, kjo e fundit ka marrë përsipër të financojë Programin (siç përcaktohet këtu më poshtë), nëpërmjet një kredie të butë deri në një shumë maksimale prej 5,000,000.00 eurosh (pesë milionë euro/00);

B. Ministria e Ekonomisë dhe Financave e qeverisë së Republikës së Italisë, me dekretin nr. 91689, të datës 2 nëntor 2016 (në vijim i referuar si "Dekreti") autorizoi CDP-në për t'i dhënë Huamarrësit një kredi të butë, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara në nenin 2 të kësaj Marrëveshjeje Financiare (në vijim e referuar si "Marrëveshja Financiare"), për qëllimin e financimit të Programit;

C. Sipas kësaj Marrëveshjeje Financiare, Palët synojnë të parashtrojnë procedurën e disbursimit dhe kushtet financiare që lidhen me kredinë e butë, siç parashikohet në nenin 8 të Marrëveshjes dhe në Dekret.

Si rrjedhojë, aktualisht kanë vendosur të lidhin këtë Marrëveshje Financiare.

Neni 1

Përkufizimet dhe interpretimi

1.1 Pjesa hyrëse dhe shtojcat e kësaj Marrëveshjeje Financiare janë pjesë përbërëse dhe thelbësore e saj.

1.2 Në këtë Marrëveshje Financiare dhe në shtojcat e saj, termat në vazhdim kanë kuptimet si më poshtë:

- "Njohje e borxhit" do të thotë deklarimi i referuar në nenin 10, me anë të të cilit Huamarrësi pranon të jetë debitor i CDP-së dhe merr përsipër, në favor të CDP-së, të rimbursojë principalin dhe çdo shumë tjetër që duhet të paguhet në lidhje me kredinë e butë që do të përgatitet në përputhje me shtojcën F (Formulari i Njohjes së Borxhit) të kësaj Marrëveshjeje Financiare.
- "AICS" do të thotë Agjencia Italiane e Bashkëpunimit për Zhvillim.
- "Llogaria e CDP-së" do të thotë llogaria e mbajtur nga CDP-ja që ka të dhënat e mëposhtme IBAN IT06Z0760203200000000000122-Bic /Swift CADPITRRXXX, e çelur nën emrin e *Cassa depositi e prestiti Società per azioni*.
- "Marrëveshje Financiare" do të thotë kjo Marrëveshje Financiare, pjesa hyrëse dhe shtojcat, të cilat janë pjesë përbërëse e saj.
- "Raport financiar" do të thotë raporti financiar që lidhet me komponentin D të kredisë së butë;
- "Periudhë e faljes" do të thotë periudha që fillon në datën e disbursimit të parë të kredisë së butë dhe mbaron 120 (njëqind e njëzet) muaj pas saj.
- "Autoritete kompetente italiane" do të thotë Ministria e Ekonomisë dhe Financave dhe/ose Ministria e Punëve të Jashtme dhe Bashkëpunimit Ndërkombëtar të Republikës së Italisë dhe/ose AICS, dhe/ose çdo autoritet tjetër kompetent i qeverisë së Republikës së Italisë, i caktuar për qëllime të kësaj Marrëveshjeje

Financiare.

- "MAECI-DGCS" do të thotë Ministria e Punëve të Jashtme dhe Bashkëpunimit Ndërkombëtar të Republikës së Italisë - Drejtoria e Përgjithshme e Bashkëpunimit për Zhvillim.

- "MEF" do të thotë Ministria e Ekonomisë dhe Financave të Republikës së Italisë.

- "MMSR" do të thotë Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë e Republikës së Shqipërisë ose çdo pasues i saj që është Agjencia Ekzekutive e Programit dhe do të përfaqësojë Huamarrësin në procedurat e disbursimit të përcaktuara në këtë Marrëveshje Financiare.

- "OECD" do të thotë Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik.

- "Kredi e butë" do të thotë huaja lehtësuese që CDP-ja, në bazë të autorizimit të parashikuar në dekret dhe në bazë të kushteve dhe afateve të përcaktuara në këtë Marrëveshje Financiare, është angazhuar t'i japë Huamarrësit.

- "Llogari e posaçme" do të thotë llogaria e çelur në emër të Huamarrësit në Bankën e Shqipërisë, ku kësti i vetëm i komponentit D) të Programit do të disbursohet në përputhje me procedurën e përmendur në nenin 8.

- "Kontratë/a furnizimi" do të thotë kontrata/t tregtare në lidhje me furnizimin e mallrave dhe/ose shërbimeve ndërmjet MMSR-së dhe furnizuesve në lidhje me realizimin e Programit.

Neni 2

Kredia e butë

2.1 Në bazë të kushteve dhe afateve të përcaktuara në këtë Marrëveshje Financiare, CDP-ja i jep Huamarrësit dhe Huamarrësi pranon kredinë e butë, që vijon:

- shuma: 5,000,000.00 euro (pesë milionë euro/00);
- kohëzgjatja: 22 (njëzet e dy) vjet;
- periudha e faljes: 120 (njëqind e njëzet) muaj, duke filluar nga data e disbursimit të parë në llogarinë e posaçme;
- shlyerja: 24 (njëzet e katër) këste principali të njëpasnjëshme, të barabarta, çdo gjashtëmujor, i pari nga të cilët bëhet detyrim për t'u paguar 120 (njëqind e njëzet) muaj pas disbursimit të parë;
- norma e interesit: 0.00% (zero pikë zero për qind);
- qëllimi i kreditimit: "Programi i arsimit dhe aftësimit profesional nëpërmjet inovacionit".

2.2 Kredia e butë do të ndahet në katër komponentë:

A. 1,263,000.00 euro (një milion e dyqind e gjashtëdhjetë e tre mijë/00) që synon financimin e rehabilitimit dhe ndërtimit të infrastrukturës;

B. 2,240,000.00 euro (dy milionë e dyqind e dyzet mijë/00) që synon financimin e laboratorëve dhe pajisjeve;

C. 1,335,000.00 euro (një milion e treqind e tridhjetë e pesë mijë/00) që synon financimin e asistencës teknike institucionale;

D. 162,000.00 euro (njëqind e gjashtëdhjetë e dy mijë/00) që synon financimin e asistencës për MMSR-në.

Komponentët sipas pikave të mësipërme: A, B dhe C, për një shumë të përgjithshme prej 4.838.000,00 eurosh (katër milionë e tetëqind e tridhjetë e tetë mijë/00) do të disbursohen në përputhje me procedurën e përmendur në nenet 5, 6 dhe 7 të kësaj Marrëveshjeje Financiare.

Komponenti në pikën e mësipërme D, deri në shumën maksimale prej 162,000.00 (njëqind e gjashtëdhjetë e dy mijë/00), do të disbursohet në përputhje me procedurën e përmendur në nenin 8 të kësaj Marrëveshjeje Financiare.

2.3 Disbursimi i parë që lidhet me komponentët sipas pikave të mësipërme: A, B dhe C dhe disbursimi i vetëm i komponentit në pikën e mësipërme D, do të kryhet me plotësimin e kushteve të nenit 3 të kësaj Marrëveshjeje Financiare dhe kushtet e përmendura në shtojcën 2 të Marrëveshjes, që duhet plotësuar dhe i komunikohet CDP-së nga MMSR-ja.

2.4 Kredia e butë do të përdoret për Programin. Kredia e butë do të përdoret për financimin e blerjes së mallrave dhe shërbimeve që kanë origjinën në vend dhe/ose nga vende të tjera fqinje në zhvillim dhe/ose nga vendet e OECD-së deri në shumën totale të kredisë së butë.

Kontratat e furnizimit do të jenë të përcaktuara në euro.

2.5 Kredia e butë nuk mund të përdoret për të financuar:

- taksat vendore, detyrimet doganore, TVSH-në.

2.6 Kredia e butë do të jetë e disponueshme në përputhje me procedurat e përcaktuara në këtë Marrëveshje Financiare.

Neni 3

Hyrja në fuqi e Marrëveshjes Financiare

3.1 Kjo Marrëveshje Financiare do të hyjë në fuqi sapo CDP-ja të ketë marrë dokumentet e mëposhtme nga Huamarrësi:

i. një deklaratë nga autoriteti kompetent i qeverisë së Republikës së Shqipërisë, i cili provon autoritetin e Huamarrësit për ta nënshkruar, në emër dhe për llogari të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, këtë Marrëveshje Financiare nga një person plotësisht i autorizuar, në përputhje me ligjet dhe rregullat në fuqi dhe me efekt të plotë në Republikën e Shqipërisë dhe të marrë përsipër detyrimet që rrjedhin nga kjo Marrëveshje Financiare;

ii. një njoftim me shkrim nga Huamarrësi për përfundimin e procedurave të tij të brendshme;

iii. caktimin me shkrim nga autoriteti kompetent i Huamarrësit (nëpërmjet Ambasadës Italiane në Republikën e Shqipërisë) të personit ose personave plotësisht të autorizuar për të nënshkruar këtë Marrëveshje Financiare, Kërkesën për financimin e kontratës së furnizimit, sipas formularit në shtojcën A; autorizimin për disbursim sipas formularit në shtojcën C, kërkesën për disbursim sipas formularit në shtojcën D dhe "Njohjen e borxhit" sipas formularit në shtojcën F, të referuar në nenin 10 më poshtë. Ky caktim duhet të specifikojë emrin dhe pozicionin e këtij/këtyre personi/personave dhe do të përmbajë të përditësuar depozitimin e nënshkrimeve të tyre. Çdo modifikim në të (nëse ka) do të transmetohet në kohën e duhur nga Huamarrësi tek CDP-ja.

3.2 CDP-ja, pas pranimit dhe plotësimit tërësor të dokumenteve të lartpërmendura, do të njoftojë Huamarrësin dhe AICS-në, me letër ose me faks që do të konfirmohet më pas me shkresë, për datën në të cilën do të hyjë në fuqi kjo Marrëveshje Financiare.

Neni 4

Afati për disbursimin e kredisë së butë

4.1 Kredia e butë do të jetë e disponueshme për disbursim nga data në të cilën të gjitha kushtet e përcaktuara në nenin 7 dhe 8 do të jenë përmbushur ose hequr nga CDP-ja, deri në (dhe duke përfshirë) datën që korrespondon 36 (tridhjetë e gjashtë) muaj pas datës së hyrjes në fuqi të Marrëveshjes Financiare. Kjo periudhë mund të zgjatet nga CDP-ja, me kërkesën me shkrim të Huamarrësit, në bazë të miratimit paraprak të autoriteteve kompetente italiane, të njoftuar me shkrim te CDP-ja para datës së skadimit të periudhës së disbursimit.

4.2 Në rastin kur periudha e disbursimit ka skaduar dhe nuk mund të zgjatet, në zbatim të nenit 4.1 më sipër, CDP-ja, pas konsultimit me autoritetet kompetente italiane, do të informojë Huamarrësin për anulimin e angazhimit të CDP-së në lidhje me fondet e papërdorura.

Neni 5

Kushtet dhe mënyrat për disbursimin e komponentëve A, B dhe C të kredisë së butë, për shumën maksimale prej 4,838,000.00 eurosh

5.1 Kredia e butë mund të përdoret nga MMSR-ja, në përputhje me kushtet që vijojnë:

i. autorizimi i dhënë nga autoritetet kompetente italiane për shpërndarjen e kontratës/ave të furnizimit në kredinë e butë;

ii. rezultati pozitiv nga verifikimi i kryer nga CDP-ja sipas nenit 5.2(i) më poshtë;

iii. marrja e kërkesës nga ana e CDP-së për financimin e kontratës së furnizimit të parashikuar sipas nenit 6.1 më poshtë.

5.2 Me marrjen e autorizimit të përmendur në nenin 5.1(i) më lart, CDP-ja do të veprojë menjëherë si më poshtë:

i. të kryejë kontroll, në bazë të kërkesave të parashikuara nga Autoritetet Kompetente Italiane, për furnizuesin dhe për kontratën/at e furnizimit. Në lidhje me kontratën/at e furnizimit, CDP-ja do të verifikojë nëse janë në përputhje me afatet dhe kushtet e kredisë së butë dhe nëse janë të detajuara në mënyrë të mjaftueshme në lidhje me kostot/analizën e çmimeve, me qëllim që të lejojnë verifikimet e parashikuara në nenin 7.2;

ii. të njoftojë MMSR-në dhe Huamarrësin për marrjen e autorizimit sipas nenit 5.1(i) më sipër dhe t'i kërkojë MMSR-së, të paraqesë kërkesën e parashikuar në nenin 6.1.

5.3 Rezultati pozitiv nga verifikimi i kryer nga CDP-ja, sipas nenit 5.2(i) më lart, do të çojë në akordimin e kontratës/ave të furnizimit në kredinë e butë. Financimi i kontratës/ave të furnizimit do të kryhet vetëm pas plotësimit të kushtit të përcaktuar në nenin 5.1(iii).

5.4 CDP-ja do të njoftojë me letër ose faks MMSR-në, Huamarrësin, AICS-në dhe furnizuesin për akordimin e kontratës/atave së furnizimit.

Neni 6

Kërkesa për financimin e kontratës së furnizimit do të disbursohet nga komponentët A, B dhe C të kredisë së butë, për shumën maksimale prej 4,838,000.00 eurosh

6.1 Pas njoftimit të rezultateve pozitive të dala nga verifikimi, sipas nenit 5.2(i), MMSR-ja do t'i dërgojë CDP-së një letër kërkese për financimin e Kontratës së Furnizimit, e nevojshme për pagesat e parashikuara në çdo kontratë furnizimi. Me anë të një kërkese të tillë, e cila do të jetë sipas formularit në shtojcën A, Huamarrësi do të pranojë që kontrata e furnizimit është e kualifikuar për t'u financuar dhe do të marrë përsipër t'i rimbursojë CDP-së shumën e disbursuar. CDP-ja duhet të njoftojë me letër ose faks MMSR-në, Huamarrësin, AICS-në dhe furnizuesin për financimin e kontratës/ave të furnizimit.

6.2 Letra e kërkesës për financimin e kontratës së furnizimit, e parashikuar në nenin 6.1, do të merret në kohën e duhur dhe në asnjë rast më vonë se gjashtë muaj nga data e njoftimit nga CDP-ja e parashikuar në nenin 5.4 më lart ose afati (nëse ka) i parashikuar në kontratën e furnizimit. Pas skadimit të periudhës së lartpërmendur, CDP-ja, pas konsultimit me autoritetet kompetente italiane, do të marrë në konsideratë anulimin e mundshëm të kontratës/ave të furnizimit të akorduara për kredinë e butë.

Neni 7

Procedura e disbursimit të komponentëve A, B dhe C të kredisë së butë, për shumën maksimale prej 4,838,000.00 eurosh

7.1 Furnizuesi duhet të dorëzojë dokumenta-cionin kontraktues origjinal në CDP dhe do të kërkojë disbursimin e shumës përkatëse në CDP, në përputhje me kontratën e furnizimit, sipas formularit në shtojcën B që do t'i dërgohet Huamarrësit dhe MMSR-së. Kopja origjinale e lartpërmendur e dokumentacionit kontraktual do të dërgohet nga CDP-ja te Huamarrësi dhe MMSR-ja.

7.2 Pas marrjes së çdo kërkese për disbursim, CDP-ja do të shqyrtojë dokumentacionin kontraktual. Një shqyrtim i tillë do të përfshijë pajtueshmërinë e dokumentacionit kontraktual me kontratën përkatëse të furnizimit.

7.3 CDP-ja do të kryejë disbursimin vetëm pas autorizimit të pagesës së MMSR-së, sipas formularit në shtojcën C, duke përjashtuar parapagimet dhe me përmbushjen e kushteve, sipas nenit 2.3 të kësaj Marrëveshjeje Financiare.

7.4 Në bazë të kontrollit pozitiv të parashikuar në nenin 7.2 dhe plotësimit të kushteve sipas nenit 7.3, CDP-ja duhet të konfirmojë me shkrim ose faks për MMSR-në dhe Huamarrësin shumën e përgjithshme të disbursimit dhe datën në të cilën janë kredituar fondet.

7.5 CDP-ja do të kryejë pagesat në favor të furnizuesit/esve dhe duhet të marrë nga ai/ata furnizues, faturën e përmbushjes së detyrimit të parashikuar në shtojcën E në dy origjinale, njëra prej të cilave do t'i kthehet MMSR-së dhe Huamarrësit.

7.6 Pas çdo pagese në interes të furnizuesit/esve, CDP-ja duhet t'i dërgojë me shkrim Huamarrësit dhe MMSR-së, një plan shlyerjeje, i cili paraqet shumat e disbursuara, duke specifikuar datat e kërkueshme për pagesë që lidhen me to në përputhje me nenin 9 më poshtë. Huamarrësi do të konfirmojë me shkrim pranimin e tij për grafikun e lartpërmendur të shlyerjes.

Neni 8

Procedura e disbursimit për komponentin D të kredisë së butë, për shumën maksimale prej 162,000.00 eurosh

8.1 Shuma prej 162,000.00 euro (njëqind e gjashtëdhjetë e dy mijë/00) që synon financimin e asistencës për MMSR-në, do të disbursohet nga CDP-ja pas plotësimit të kushteve, sipas nenit 2.3 të kësaj Marrëveshjeje Financiare.

8.2 Kërkesa për disbursim e transmetuar nga MMSR-ja, në përputhje me shtojcën D, në shumën prej 162,000.00 (njëqind e gjashtëdhjetë e dy mijë/00), do të ekzekutohet brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së kërkesës nga CDP-ja.

8.3 Brenda 24 (njëzet e katër) muajve nga data e disbursimit, MMSR-ja do të dërgojë tek AICS, CDP dhe Huamarrësi një raport financiar në lidhje me rregullsinë dhe pajtueshmërinë me kushtet e vendosura në Marrëveshje dhe në këtë Marrëveshje Financiare për çdo transaksion financiar që lidhet me shumën e disbursuar. AICS-ja dhe CDP-ja duhet të informojnë MMSR-në dhe Huamarrësin për rezultatet e verifikimit brenda 20 (njëzet) ditëve kalendarike nga data e marrjes së raportit financiar.

8.4 Huamarrësi merr përsipër në mënyrë të parevokueshme që të kthejë te CDP-ja shumat e barabarta me shpenzimet e pamiratuara nga AICS-ja dhe CDP-ja.

8.5 Nëse ndonjë shumë e kredituar në MMSR nga CDP-ja nuk do të përdoret brenda 24 (njëzet e katër) muajve nga data e disbursimit, kjo shumë do të kthehet menjëherë te CDP nga MMSR-ja. Ky transferim do të bëhet pa vonesë pas komunikimit, të rënë dakord me AICS-në, nga CDP-ja te Huamarrësi dhe MMSR-ja, dhe me çdo mjet, brenda një muaji nga komunikimi i CDP-së.

8.6 Pas disbursimit të fondeve në llogarinë e posaçme, CDP-ja do të përcjellë me shkresë te Huamarrësi dhe MMSR-ja, grafikun përkatës të shlyerjes, duke treguar datat përkatëse të pagesës. Një skemë e tillë shlyerjeje, e plotësuar në përputhje me kushtet e përcaktuara në nenin 9 më poshtë, do të pranohet me shkrim nga Huamarrësi.

Neni 9

Shlyerja e kredisë së butë

9.1 Çdo shumë e disbursuar do të shlyhet sipas grafikut të shlyerjes në 20 (njëzet) këste të njëpasnjëshme, të barabarta, çdo gjashtëmujor (në vijim të referuara si "Këste të Principalit"), i pari nga të cilët bëhet detyrim për t'u paguar 120 (njëqind e njëzet) muaj nga data e disbursimit të parë. CDP-ja duhet t'i dërgojë Huamarrësit grafikun e shlyerjes në përputhje me nenet 7.6 dhe 8.6.

9.2 Për Kështet e Principalit të mbetura pa shlyer dhe efektivisht të krediturara, interesi i mbetur do të llogaritet me një normë nominale vjetore prej 0.00% (zero pikë zero për qind).

9.3 Huamarrësi merr përsipër të kryejë të gjitha shlyerjet e marra sipas kësaj Marrëveshjeje Financiare, si dhe në bazë të njohjes së borxhit pa vonesë: në datën aktuale të pagesës, për shumën korresponduese në euro, në favor të CDP-së ose personit që ka të drejtë. Këto shuma do të kreditohen pa asnjë zbritje të ndonjë komisioni bankar dhe/ose tarife shkëmbimi valutor dhe/ose tatimor dhe pa qenë e nevojshme njoftimi për këtë nga CDP-ja ose personat e caktuar të cilëve iu është kërkuar. Huamarrësi do të marrë njoftim përpara datës së shlyerjes të duhur. Nëse Huamarrësi, për çfarëdo arsye, nuk merr njoftimin e lartpërmendur, ai do të ndërmarrë, gjithsesi, të kryejë të gjitha pagesat sipas grafikut të shlyerjes pa vonesë. Për çdo shlyerje, Huamarrësi do të përcaktojë në CDP numrin e Marrëveshjes Financiare dhe shumën totale të kredisë së butë dhe do të detajojë për secilën datë të duhur shumat e paguara.

Neni 10

Dorëzimi i njohjes së borxhit

10.1 Brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve kalendarike nga data e fundit e skadimit të disbursimit të kredisë së butë të përcaktuar në nenin 4.1, Huamarrësi do të dorëzojë te CDP-ja "Njohjen e borxhit", të nënshkruar dhe të sigluar në mënyrë të duhur nga Huamarrësi në çdo faqe, sipas formularit në shtojcën F).

10.2 Grafiku i shlyerjes i parashtruar në "Njohjen e borxhit" do të plotësohet duke mbledhur të gjitha kështet e principalit që nuk janë maturuar ende të parashikuara në grafikun përkatës të shlyerjes për çdo disbursim, në përputhje me dispozitat e neneve 7.6 dhe 8.6.

10.3 CDP-ja duhet të depozitojë "Njohjen e borxhit" për regjistrimin dhe administrimin e tij dhe, herë pas here, do të regjistrojë në "Njohjen e borxhit" çdo pagesë të shumës së principalit dhe sa më shpejt të jenë kryer të gjitha pagesat e parashikuara në "Njohjen e borxhit", CDP-ja do t'i kthejë Huamarrësit "Njohjen e borxhit", të nënshkruar siç duhet për pranim.

Neni 11
Angazhimi i Huamarrësit

Angazhimi i Huamarrësit për të paguar shumat e kërkueshme sipas kësaj Marrëveshjeje Financiare dhe "Njohjes së borxhit" që lidhet me të, është i pavarur, absolut, i pakushtëzuar dhe i parevokueshëm.

Neni 12
Pengesat dhe forca madhore

Në rast të pengesave për zbatimin e Programit për arsye të forcës madhore (të tilla si: lufta, përmbytja, zjarri, tajfuni, tërmeti, konfliktet e punës dhe grevat, vështirësitë e papritura të transportit dhe arsye të tjera) do të zbatohen dispozitat e përcaktuara në nenin 12 të Marrëveshjes. CDP-ja duhet të ndjekë udhëzimet nga autoritetet kompetente italiane në lidhje me veprimtaritë e Programit.

Neni 13
Pezullimi i disbursimit

13.1 Gjatë periudhës së disbursimit të kredisë të butë, CDP-ja ruan të drejtën të pezullojë çdo kërkesë për disbursim sipas neneve 7 dhe 8, në rast të ndonjë mosrealizimi kundrejt CDP-së, sipas kësaj Marrëveshjeje Financiare ose çfarëdo kredie tjetër të butë të dhënë nga qeveria e Republikës Italiane për qeverinë e Republikës së Shqipërisë, në bazë të nenit 8, të ligjit nr. 125/2014, të Republikës Italiane, të ndryshuar herë pas here. CDP-ja do të informojë në kohë Huamarrësin për një pezullim të tillë.

13.2 CDP-ja do të ekzekutojë çdo kërkesë për disbursim të parashikuar në nenet 7 dhe 8, në rast se shumat përkatëse vihen në dispozicion nga autoritetet kompetente italiane. CDP-ja nuk do të konsiderohet përgjegjëse kundrejt Huamarrësit, në rast se shumat për t'u disbursuar në bazë të kredisë së butë nuk do të bëhen të disponueshme nga autoritetet kompetente italiane.

Neni 14
Interesi në rast vonese/kamatëvonesa

14.1 Nëse për çfarëdolloj arsyeje, CDP-ja nuk merr shumat e kërkueshme për principalin brenda datës së caktuar, Huamarrësi do të jetë i detyruar t'i paguajë CDP-së, për shumat e lartpërmendura, kamatëvonesa që nga data e detyrimit deri në datën e kreditimit efektiv në favor të CDP-së ose të personit/ave të caktuar për këtë qëllim.

14.2 Ky interes do të llogaritet duke zbatuar formulën e interesit të thjeshtë.

Kamatëvonesa nuk do të llogaritet për periudhën 35 (tridhjetë e pesë) ditë, menjëherë pas datës fillestare të detyrimit për pagesë dhe më pas do të llogaritet me një normë 0.10% (zero pikë dhjetë për qind) deri në datën e kreditimit efektiv në favor të CDP-së. Kamatëvonesa e kësaj të fundit do të përditësohet periodikisht nga autoritetet kompetente italiane.

Neni 15
Taksat

15.1 Çdo taksë në fuqi në të tashmen apo në të ardhmen, e cila mund të jetë e detyrueshme për pagesë në Shqipëri, për çfarëdolloj arsyeje në lidhje me këtë Marrëveshje Financiare dhe me "Njohjen e borxhit", do të mbulohet ekskluzivisht nga Huamarrësi.

15.2 Çdo taksë e kërkueshme për t'u paguar në Itali në lidhje me këtë Marrëveshje Financiare, nuk do të mbulohet nga Huamarrësi.

Neni 16
Ligji i zbatueshëm

Kjo Marrëveshje Financiare do të zbatohet dhe interpretohet në përputhje me ligjin italian.

Neni 17
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

17.1 Palët e kësaj Marrëveshjeje do të bëjnë përpjekje për të zgjidhur në mirëkuptim çdo mosmarrëveshje që lind prej ose nga interpretimi dhe/ose zbatimi i kësaj Marrëveshjeje Financiare.

17.2 Nëse këto përpjekje nuk çojnë në një zgjidhje të mosmarrëveshjes brenda një afati të arsyeshëm, atëherë mosmarrëveshja do të zgjidhet në nivel qeveritar.

17.3 Nëse edhe kjo përpjekje do të dështojë (nëse është bërë përpjekje) ose nuk sjell një rezultat të kënaqshëm, të gjitha mosmarrëveshjet që lindin prej ose që lidhen me këtë Marrëveshje Financiare, do të zgjidhen, përfundimisht sipas Rregullores së Arbitrazhit të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë, Paris, Francë, nga një gjykatë arbitrazhi me tre arbitra:

- një arbitër i caktuar nga Huamarrësi;
- një arbitër i caktuar nga CDP-ja;
- arbitri i tretë caktohet nga arbitrat e lartpërmendur ose në rast të mosrënies dakord të tyre, prej kryetarit të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë, Paris.

17.4 Nëse Huamarrësi ose CDP-ja nuk caktojnë arbitrin brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga kërkesa e palës tjetër, ky arbitër do të caktohet nga kryetari i Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë, Paris.

17.5 Vendimi i Gjykatës së Arbitrazhit, i cili do të vendosë sipas Ligjit të Republikës së Italisë, do të jetë përfundimtar dhe pa kushte, i detyrueshëm për zbatim nga të dyja palët pa asnjë mundësi për ta apeluar.

17.6 Asnjë mosrënie dakord dhe asnjë mosmarrëveshje që mund të lindë midis palëve të këtushme, nuk do të pezullojë detyrimin e Huamarrësit për të paguar, në datat e detyrim, të rëna dakord, për të gjitha shumat detyrim sipas kësaj Marrëveshjeje Financiare dhe, veçanërisht, të gjitha shumat që rezultojnë nga grafikët e shlyerjes të përcaktuara në nenet 7.6 dhe 8.6 më lart dhe nga "Njohja e borxhit" e lidhur me të.

Neni 18

Njoftimet

Njoftimet që do të kryhen në përputhje me këtë Marrëveshje Financiare, do të dërgohen në adresat e mëposhtme:

- Ministria e Financave dhe Ekonomisë e Republikës së Shqipërisë, bulevardi "Dëshmorët e Kombit", nr. 3, Tiranë, Shqipëri;

Tel.: +355 -4- 228405- Faks: +355 -4- 2228494;

Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë e Republikës së Shqipërisë, Rruga e Kavajës, Tiranë Shqipëri...;

- Cassa depositi e prestiti S.p.A. - International Development Cooperation Department Via Goito 4 – 00185 Rome Italy e-mail: fondorotativocs@cdp.it.

Neni 19

Çdo amendament i kësaj Marrëveshjeje Financiare duhet të bëhet me shkrim ndërmjet CDP-së dhe Huamarrësit. Ministri i Financave dhe Ekonomisë i Republikës së Shqipërisë është i autorizuar të nënshkruajë çdo amendament, i cili duhet të miratohet nga Këshilli i Ministrave të Shqipërisë. Për amendamentet në këtë Marrëveshje Financiare që prekin vetëm afatin e disbursimit nuk do të jetë i nevojshëm miratimin paraprak i Këshillit të Ministrave të Shqipërisë.

Neni 20

Tekstet origjinale të Marrëveshjes Financiare

Kjo Marrëveshje Financiare nënshkruhet në tri origjinale në gjuhën angleze, CDP-ja mban dy origjinale dhe Huamarrësi një origjinal.

Cassa depositi e prestiti S.p.A.	Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, i përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë
Nënshkruar në... më...	Nënshkruar në... më...

(Formulari i kërkesës për financimin e kontratës së furnizimit)

Shtojca A

Nga: ..... (MMSR)

Për: Cassa depositi e prestiti S.p.A.

Marrëveshja Financiare për .... (.....) euro, e nënshkruar nga ....., në ....., më ....., dhe nga Cassa depositi e prestiti S.p.A. në ...., më .....

Në zbatim të nenit 6 të Marrëveshjes Financiare të lartpërmendur, ne dëshirojmë t'ju informojmë se kontrata e furnizimit, këtu bashkëlidhur, nr. ....., datë ....., midis ..... dhe ....., lidhur me ..... (Projektin), është e kualifikuar për financim.

Si rrjedhojë, ne ju kërkojmë që të financoni shumën përkatëse prej eurosh ..... (.....), e cila u korrespondon pagesave, detyrim nga ana jonë, për ..... (furnizuesi), që ju do të kryeni në përputhje me kushtet e Kontratës së Furnizimit.

Për këtë qëllim, ne pranojmë se pagesat që ju do të kryeni në favor të furnizuesit, të treguara nga vetë ne, do të varen nga procedura e përmendur në nenin 7 të Marrëveshjes Financiare.

Në këtë kuptim, ju do të na dërgoni origjinalin e dokumentacionit kontraktual, si dhe një nga dy origjinalet e faturës së paguar.

Me anë të kësaj, ne ju konfirmojmë se Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë merr përsipër, pa kushte dhe, në mënyrë të pakthyeshme, të shlyejë çdo shumë të kredituar nga ju në llogarinë e furnizuesit, sipas kushteve dhe afateve të parashikuara në Marrëveshjen Financiare.

Brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditësh nga data e skadimit të afatit të fundit të disbursimit të kredisë së butë, të përcaktuar në nenin 4 të Marrëveshjes Financiare, ne marrim përsipër të lëshojmë një "Njohje të borxhit" për shumën e principalit që korrespondon me shumën totale të të gjitha disbursimeve të kryera sipas Marrëveshjes Financiare.

Kjo "Njohje e borxhit" do të jetë sipas formularit në shtojcën F të Marrëveshjes Financiare.

Me respekt,

(……..)

Datë ...

Nënshkrimi i MMSR-së

(Formulari i kërkesës për disbursim)

Shtojca B

Nga: .....(furnizuesi)
Për: Cassa depositi e prestiti S.p.A.
Në vëmendje të: (Huamarrësi)
… (MMSR)
Marrëveshja Financiare për .... (.....) euro, nënshkruar nga ....., në ....., më ..... dhe nga Cassa depositi e prestiti S.p.A., në ...., më .....

Të nderuar zotërinj,

Duke iu referuar kontratës së furnizimit, nr. ..... datë ....., midis nesh dhe ..... (blerës) për shumën prej .... (...) eurosh, lidhur me ..... (projektin), ne ju dërgojmë dokumentacionin kontraktual që vijon për shumën .... (....) euro:

.....
.....
.....

Ne ju kërkojmë të disbursoni shumën e lartpërmendur, me konfirmimin e MMSR-së, në llogarinë bankare që vijon:

IBAN: ..... Çelur në emër të: ..... Banka: ....., nr. telefoni i zyrës së degës: ..... nr. faksi i zyrës së degës: .....

Me respekt,

Datë ...

Nënshkrimi

(Formulari i autorizimit për disbursim)

Shtojca C

Nga: ..... (MMSR)
Për: Cassa depositi e prestiti S.p.A.
Në vëmendje të: ..... (Huamarrësi)

Marrëveshja Financiare për ..... (.....) euro, e nënshkruar nga ....., në ....., më ..... dhe nga Cassa depositi e prestiti S.p.A., në ...., më .....

Të nderuar zotërinj,

Në zbatim të nenit 7 të Marrëveshjes Financiare të lartpërmendur, ne dëshirojmë t'ju informojmë se kemi marrë origjinalin e dokumentacionit kontraktual në lidhje me kontratën e furnizimit nr. ....., datë ....., midis ..... dhe ....., në lidhje me ..... (projekti), për shumën që duhet paguar prej .... (....) eurosh.

Ne vërtetojmë që dokumentet kontraktuale të cituara më lart janë të rregullta sipas kontratës së cilës i referohen.

Ne ju autorizojmë që të paguani kundërvlerën e dokumenteve përkatëse në favor të .... (furnizuesi).

Me respekt,

(……..)

Data ...

Nënshkrimi i MMSR-së

(Formulari i kërkesës për disbursim)

Shtojca D

Nga: …. (MMSR)
Për: Cassa depositi e prestiti S.p.A.
Në vëmendje të: …… (Huamarrësi)

Marrëveshja Financiare prej ..... eurosh, e nënshkruar nga ne në ....., më ..... dhe nga Cassa depositi e prestiti S.p.A., në ...., më .....

—

Në zbatim të nenit 8 të Marrëveshjes Financiare të lartpërmendur, ne ju kërkojmë që të kreditoni brenda 30 (tridhjetë) ditësh, në llogarinë e posaçme (siç është përcaktuar në të) me nr. IBAN ..... dhe çelur në Bankën ....., shumën prej..... (.....) euro, me kusht që fondet përkatëse të jenë vënë në dispozicion nga autoritetet kompetente italiane (siç përcaktohet në të).

Fondet e kredituara nga ju në llogarinë e posaçme do të shfrytëzohen për zbatimin e Programit "...".

Huamarrësi me këtë rast merr përsipër, në mënyrë të pakushtëzuar dhe të pakthyeshme, të shlyejë shumën e përmendur prej ..... eurosh, të kredituar nga ju në llogarinë e posaçme, sipas afateve dhe kushteve të përcaktuara në Marrëveshjen Financiare të lartpërmendur.

Brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga data e skadimit të afatit të fundit të disbursimit të kredisë së butë, të përcaktuar në nenin 4 të Marrëveshjes Financiare, Huamarrësi merr përsipër t'i lëshojë CDP-së një "Njohje të borxhit" për të gjitha shumat e disbursuara sipas Marrëveshjes Financiare të lartpërmendur.

"Njohja e borxhit" do të jetë sipas formularit në shtojcën F të Marrëveshjes Financiare të lartpërmendur.

Me respekt,
Datë ...

Nënshkrimi i MMSR-së

(Formulari i vërtetimit për faturë të paguar)

Shtojca E

Nga: Furnizuesi
Për: ……. (MMSR)
Për: Cassa depositi e prestiti S.p.A.
Në vëmendje të: …… (Huamarrësi)

Vërtetimi për faturë të paguar

Duke iu referuar kontratës së furnizimit nr. ..... nënshkruar më .....,. ndërmjet shoqërisë sonë dhe ....., për furnizimin e ....., ne, me anë të kësaj, konfirmojmë se kemi marrë shumën prej..... (.....) eurosh, si pagesë të pjesshme/totale të kësaj kontrate furnizimi.

Kjo shumë lidhet me kredinë e butë prej ..... (.....) eurosh, të dhënë nga CDP-ja për Këshillin e Ministrave të Republikës së Shqipërisë, në zbatim të nenit 8, të ligjit nr. 125, të datës 11 gusht 2014, me ndryshimet e pësuara herë pas here, me anë të Marrëveshjes Financiare të nënshkruar në ....., më ..... dhe në ..., më .....

Prandaj, ne, me anë të kësaj, konfirmojmë se jemi paguar tërësisht për shumën e pjesshme/totale detyrim sipas kredisë së butë, si pagesë për shumën prej ..... (.....) eurosh dhe se Huamarrësi dhe CDP-ja nuk janë përgjegjës për ndonjë apo për të gjitha komisionet dhe përgjegjësitë që lidhen me shumën e marrë.

Datë …

Nënshkrimi

(Formulari i njohjes së borxhit)

Shtojca F

(Huamarrësi)
Nr. .....
Vendi dhe data e lëshimit: .....

Në lidhje me Marrëveshjen Financiare ndërmjet ..... (Huamarrësi), i cili vepron në emër të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë ... dhe CDP-së, të nënshkruar në ....., më ....., dhe në ....., më ....., ... (Huamarrësi) pranon marrjen e shumave që vijojnë nga CDP-ja:

.... on .....

Prandaj, ... (Huamarrësi), me anë të kësaj, deklaron pa kushte dhe në mënyrë të pakthyeshme, të jetë debitor ndaj CDP-së, si administrator i Fondit Qarkullues për Bashkëpunim e Zhvillim, në emër të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave të Italisë, me zyrë të regjistruar në Romë (Itali), Via Goito 4, për shumën e principalit prej .... (.... .....) eurosh, të cilën ai merr përsipër ta shlyejë në ... (.....) këste të barabarta, të njëpasnjëshme, i pari i të cilëve do të bëhet detyrim për t'u paguar, më ... . dhe i fundit, më ....., sipas grafikut të shlyerjes të përcaktuar këtu më poshtë.

..... (Huamarrësi) do të shlyejë kështet e principalit të parashikuara në këtë "Njohje borxhi", duke kredituar shumat përkatëse në euro, në datat e detyrimit, të rëna dakord, në favor të CDP-së, në llogarinë e CDP-së, pa ndonjë tarifë shërbimi bankar dhe/ose këmbimi valutor.

Nëse CDP-ja, për çfarëdolloj arsyeje, duke përfshirë edhe arsyet jashtë kontrollit të Huamarrësit, nuk merr në datën e detyrimit, shumat detyrim për principalin e parashikuar në këtë "Njohje borxhi", Huamarrësi do të jetë i detyruar të paguajë në llogarinë e CDP-së, kamatëvonesa për këto shuma që nga data e detyrimit deri në datën e kreditimit efektiv në favor të CDP-së.

Kjo kamatëvonesë do të llogaritet duke zbatuar formulën e interesit të thjeshtë. Kamatëvonesa nuk do të llogaritet për periudhën prej 35 (tridhjetë e pesë) ditësh menjëherë pas datës fillestare të detyrimit për pagesë dhe më pas do të llogaritet në masën ...% (... për qind) deri në datën e kreditimit efektiv në favor të CDP-së.

..... **(inicialet/sigla e Huamarrësit)**

vazhdon

Shtojca F vijon

Ky interes i fundit do të përditësohet periodikisht nga autoritetet kompetente italiane.

CDP-ja do të shënojë, herë pas here, në këtë "Njohje borxhi" çdo pagesë të principalit.

Menjëherë sapo të jenë kryer të gjitha pagesat e renditura në grafikun e shlyerjes të përcaktuar më poshtë, kjo "Njohje borxhi" do t'i kthehet ..... (Huamarrësi).

Kjo "Njohje borxhi" lëshohet në zbatim të kredisë së butë prej .... (... ..) eurosh.

GRAFIKU I SHLYERJES

	Data e maturimit	**Kështet e principalit**	**TOTALI**
a)			.....
b)			.....
c)			.....
d)			.....
.....			
.....			
1)	.....		.....
2)	.....		.....

(.....)

(Nënshkrimi i Huamarrësit)